



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/85
Datë: 29.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Të gjithë pronarëve të mjeteve të pajisura me targa "PR", "KM", "PZ", "GL", "UR", "PE", "DA" apo "ĐA" nga 10 qershori i vitit 1999 deri më 21 prill 2022, iu mundësohet regjistrimi i mjeteve me targa RKS.
2. Regjistrimi i mjeteve sipas pikës 1. të këtij Vendimi do të fillojë më 1 gusht 2022 dhe do të zgjasë deri më 30 shtator 2022.
3. Automjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi, që hyjnë në këtë fushëveprim, për periudhën e cekur dhe të papërsëritshme sipas pikës 2. të këtij Vendimi, konsiderohen mallra të nacionalizuara.
4. Njohja e një të drejte të tillë sipas pikës 1. të këtij Vendimi ka karakter të papërsëritshëm pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë.
5. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme me qëllim të realizimit të procesit sipas pikës 1. të këtij Vendimi si dhe të bëjë bashkërendimin e procesit të regjistrimit në koordinim me ministrinë relevante.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/85
Datë: 29.06.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Çdo person që paraqitet për kalim të kufirit shtetëror me dokument të identifikimit personal të lëshuar nga autoritetet e Serbisë, do të pajiset në pikë-kalimet kufitare me një fletë-deklarim që përkohësisht e zëvendëson përdorimin e dokumentit të tillë.
2. Fletë-deklarimi, nga pika 1. e këtij Vendimi, do të krijojë bazë për qarkullim në territorin e Republikës së Kosovës dhe për shfrytëzim brenda institucioneve shtetërore.
3. Automjetet me targa të regjistrimit të Serbisë që paraqiten për kalim të kufirit shtetëror dhe kanë për qëllim të lëvizin në territorin e Republikës së Kosovës, duhet të kenë të vendosur ngjitësin në pjesën e simboleve dhe emërtimit shtetëror nga data 1 gusht 2022. Mekanizmi i tillë do të vlejë deri me 31 tetor 2022. Ky mekanizëm është pa paragjykim ndaj afatit maksimal të qëndrimit të automjeteve të tilla në territorin e Republikës së Kosovës sipas nenit 41 të Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme dhe të domosdoshme, me qëllim të realizimit të procesit sipas këtij Vendimi, dhe të bëjë bashkërendimin e zbatimit të kësaj mase në koordinim me ministrinë relevante.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë